

VENDIM
Nr.158, datë 18.11.2004

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E
PROKURIMEVE PUBLIKE TË KRYEMINISTRISË DHE MINISTRIVE**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor i Kuvendit për Hetimin e Prokurimeve Publike të Kryeministrit dhe Ministrave.

II. Komisioni Hetimor i Kuvendit ka për detyrë hetimin e prokurimeve publike të kryera nga Kryeministria dhe ministrat nga data 1 janar 2002 deri në datën e ngritjes së Komisionit.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga pozita dhe 5 nga opozita.

IV. Kryetari i Komisionit është përfaqësues i opozitës.

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej tre muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi